



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Plani i punës për vitin 2022

I. Hyrje

Në Komunën e Podujevës Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale punën e organizon në shërbimet primare shëndetësore- Sektori i Shëndetësisë, shërbimet sociale-sektori i Mirëqenies Sociale dhe Qendrën për Punë Sociale.

Objektivat kryesore të DSHMS për vitin 2022

- Përparimi, parandalimi, mjekimi, shërimi dhe rehabilitimi që ka të bëjë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, Edukimi i vazhdueshëm profesional, Imunizimi dhe vaksinimi, Përcaktimi i diagnozës fillestare dhe kujdesi parësor shëndetësor përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike, Promovimi i shëndetit oral dhe kujdesi themelor stomatologjik, Kujdesi për shëndetin mendor bazuar në bashkësi, Kujdesi shëndetësor riprodhues që përfshinë kujdesin shëndetësor gjatë shtatzënisë, lindjes, dhe lehonave, si dhe metodat e planifikimit të familjes, Zbulimi i hershem i sëmundjeve ngjitëse, Kryerja e shërbimeve specialistike dhe diagnostike, analizave laboratorike dhe röntgenologjike në kujdesin parësor shëndetësor, Diagnostifikimi i hershëm dhe trajtimi i tuberkulozit, Organizimi i shërbimeve Urgjente dhe Emergjente si pjesë e sistemit unik, Shërbimi i kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë, Mbrojtja e parashkollorëve nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve, dhe të rinjve në shkollat fillore dhe të mesme, Shërbimi Paliativ.
- Në kuadër të mjekësisë familjare ekziston edhe sistemi informative shëndetësor, i cili grumbullon të dhënat shëndetësore dhe ia dërgon ISHP në Prishtinë.
- Furnizimi më i mirë me barëra dhe material shpenzues nga Lista Esenciale e Barërave nga buxheti i MSH dhe Furnizimi me barëra dhe material shpenzues nga kontrata me buxhet të DSHMS,
- Furnizimi me pajisje mjekësore, furnizimi me pajisjet e teknologjisë informative, furnizimi me pajisje për digjitalizimin e shërbimeve në QKMF
- Bashkëpunimin me të gjitha institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare përfshirë organizatat qeveritare, joqeveritare, donatorë të ndryshëm dhe njerëzit e vullnetit të mirë.
- Bashkëpunimi me MSH dhe të Punës dhe Mirëqenies Sociale, në gjithë segmentet ku është e mundur dhe i nevojshëm ai.
- Identifikimi i familjeve në teren lidhur me nevojat sociale ekonomike dhe të banimit, identifikimin e personave të moshuar, vetmuar dhe hendikepuar.
- Puna e Qendrës për Punë Sociale mbështetët në idealet e humanitetit, barazisë, drejtësisë sociale si dhe përkushtimit ndaj qytetarëve, punëtorët janë të angazhuar që në mënyrë sa më profesionale të ofrojnë shërbime qytetarëve në nevojë të cilët në mënyra të ndryshme kanë kërkuar shërbime.

II.1. Sektori i Shëndetësisë- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)

QKMF në Podujevë është i vetmi institucion shëndetësor publik që përkujdesët për shëndetin e afër 90 mijë banorëve të Komunës së Podujevës, QKMF ofron shërbime parësore shëndetësore për popullatën të Komunës, përmes zbatimit të kapaciteteve të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësorë të Kosovës. Në strategjinë e zhvillimit të Mjekësisë Familjare parashihet që në 2000 banorë të ketë një (10) mjek dhe dy (2) infermier/e si dhe në çdo 6000 banorë të ketë një (1) stomatolog/e dhe dy (2) teknik/e dental. QKMF në Podujevë

Kujdesi Parësor Shëndetësor për qytetarët e Komunës e Podujevës është i organizuar nëpërmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Podujevë, katër (4) Qendra të Mjekësisë Familjare- QMF, tetëmbëdhjetë (18) Ambulanta të Mjekësisë Familjare- AMF.

Plani i aktiviteteve për vitin 2022

Planifikimi dhe programimi i punës për vitin 2022 është i bazuar në legjislacionin aktual për shëndetësi, mundësitë dhe nevojat e popullatës, resurseve humane dhe hapësira për zhvillimin e aktiviteteve mjekësore dhe jo mjekësore (trajnimet e ndryshe të stafit mjekësor). Puna e QKMF Podujevë bazohet në Ligjin mbi shëndetësinë e Kosovës, Ligjin e punës, Statutin e QKMF dhe Aktet tjera nënligjore të Ministrisë së shëndetësisë. Konsiderojmë që QKMF, përkundër vështirësive në vitin paraprak si pasojë e ballafaqimit me pandeminë Covid -19, besojmë se me sukses do të kryen detyrat e parashtruara me këtë program pune. Në vitin 2022 përkundër vështirësive që do të kemi në punë, ne presim rezultate të kënaqshme në pikëpamje të angazhimit të punëtorëve në procesin e punës, përmirësimit të disiplinës në punë, organizimit me të mirë dhe efikas të punës, angazhimit maksimal të secilit punëtor, mjek, infermier dhe personel tjetër si në QKMF ashtu edhe në QMF dhe AMF në teren.

Kusht i qenësishëm për realizimin e suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave të përcaktuara me këtë program pune, është jetësimi i plotë i detyrave që dalin nga Ligji për shëndetësi, Ligji i punës, Statuti dhe aketet normative në drejtim të realizimit dhe krijimit të kushteve për punë që kërkojnë: aktet

- kualitet dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore
- kursim maksimal, racionalitet dhe modernizim të punës në bazë të të arriturave më të reja shkencore,
- pajisja me mjete të nevojshme dhe aparaturë mjekësore.
- përcaktimi real i nevojave dhe mundësive material në shëndetësi
- krijimi i kushteve për perfeksionim profesional, specializime, trajnime sipas planeve të posaçme dhe strukturës ligjore.

Me këtë program vjetor pune parashihen masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në QKMF, QMF dhe AMF, organizimi dhe udhëheqja, burimet njerëzore dhe plani financiar për këtë vit.

Veprimtaria e QKMF, QMF dhe AMF është që të bëjë ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor popullatës së komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror nëpërmes të zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare.

Shërbimet Shëndetësore:

Gjatë vitit 2022 planifikohet që numri i shërbimeve shëndetësore të rritet si në Qendër dhe në QMF dhe AMF, duke pasur parasysh futjen në përdorim të aparaturave të reja dhe rritjen numrit të shërbimeve sidomos në QMF. Pritet të ketë një rritje të shërbimeve shëndetësore krahasuar me vitin 2021 në këto shërbime:

- Emergjencë-përdorimi i aparaturës së re mjekësore me të cilën disponohet, pritet të shënoj një rritje edhe më cilësore të shërbimeve shëndetësore.
- Laborator-puna me aparaturë të blerë dhe nga donacioni pritet të shënoj një rritje cilësore e të shërbimeve laboratorike si në qendër njashtu edhe në tre (3) QMF në teren.
- Këshillimorja për Diabet dhe Hipertension e cila vitin e kaluar ka ofruar 5.466 vizita + shërbime e cila ka ndihmuar shumë sidomos të sëmurë me Diabet dhe Hipertension. Sponzorizimi i këtij projekti do të jetë edhe më i sukseshëm nëse kemi sponzorizues që ofrojnë donacion për një funksionalizim më të mirfilltë dhe më funksional, i cili është shumë domethënës për kategoritë e lartpërmendura. Në kuadër të këtij shërbimi janë të angazhuara dy (2) Infermiere të diplomuara të cilat me performancën e tyre kanë ndihmuar shumë këto kategori. Planifikojmë që ky shërbim do të zgjerohet në shtrirjen e shërbimeve në kuadër të dhënjes së këshillave për menagjimin e Hipertensionit të Diabetit dhe të përpunimit të plagëve diabetike si dhe menagjimit standard të terapisë si dhe dhënjes së këshillave për ushqyeshmeri.
- Imunizimit t'i kushtohet rëndësi e veçantë, kërkojmë që kjo të jetë vazhdimësi e përhershme në realizimin e sukseshëm të vaksinimit.
- Shërbimi stomatologjik oral-Planifikohet vazhdimi me punë e shërbimeve stomatologjike në QMF: Orllan, Kërpimëh, Lluzhan. Kjo bëhet me qëllim që QMF-të të gëzojnë statusin e plotë, pasi që ndodhen në afërsi të shkollave dhe nxënësit të kenë qasje të lehtë në këto shërbime, ku kjo paraqet një parametër të rëndësishëm në implementimin e Mjekësisë familjare. Kësaj do t'i ndihmojë dukshëm rajonizimi (regjionimi) i qytetit të Podujevës në mënyrë që qytetarët të drejtohen për ndihmën mjekësore aty ku e kanë më afër.
- QKMF, QMF dhe AMF në teren veprimtarin e tyre themelore e ushtrojnë duke ofruar shërbime shëndetësore, qytetarve të komunës që kërkojnë ndihmën mjekësore. Planifikimi i shërbimeve shëndetësore në vitin 2022, bazohet në numrin e përgjithshëm të banorve të komunës, mundësive hapsinore të objekteve, potencialit kadrovik, patologjisë të sëmundjeve të popullsisë, epidemitë e ndryshme, gjendjet e jashtëzakonshme dhe emergjente nga fatkeqësitë elementare, epidemitë e ndryshme, lëndime dhe helmime masovike, tërmetet, zjarret, vërshimet, raste të bioterorizmit të cilat kanë ndikim në shtimin e numrit të shërbimeve shëndetësore. Numri i shërbimeve do të rritet për afro 5-10% duke patur për bazë edhe shtimin e shërbimeve shëndetësore të cilat deri më sot nuk i kanë marrë qytetarët.

Këtë vit duhet kushtuar kujdes të veçantë realizimit të planit vjetor të imunizimit dhe të vaksinimit, që gjithsesi suksesi të jetë mbi 96%. Duhet vazhduar me vaksinimin kundër COVID-19, si dhe gripit të rëndomtë.

Shërbimet joshëndetësore:

Në Departamentin e Administratës të kryhen të gjitha punët administrative-juridike dhe të kontabilitetit të QKMF nëpërmes zyrave të cilat janë njësi të saj. Do të kushtohet rendesi e veqante afarizmit materialo-financiar, pagesave, bashkëpagesave dhe të mbahen pasqyrat financiare sipas udhëzimeve dhe ligjit.

-**SISH** Sistemi informativ shëndetësor i QKMF në Podujevë (SISH-i) gjatë vitit 2022 Planifikojmë që në bazë të aplikimit të sistemit të ri të futjes së të dhënave në kopjuter edhe ky shërbim t'a zgjeroj rrjetin e vetë dhe të lidhet në të njëjtën kohë edhe me shërbimet gjegjëse mjekësore në teren , në menyre që në çdo kohë të kemi qasje në përbldhjen e të dhënave për shërbimet e kryera dhe njëkohesisht këto të dhëna t'i transferojmë në nivelet tjera shëndetësore të sistemit që ky shërbim të shpërndalet në minimum 4 pika në teren kryesisht në QMF, ku volumi i punës është më i madh.

Projektet e planifikuara për vitin 2022

Aktiviteti	Afati Kohor	Kosto Financiar
Furnizim me barna dhe reagens	Shkurt dhjetor 2022	350,000.00€
Servisimi i Pajisjeve mjekësore	Mars dhjetor 2022	30,000.00€
Pajisje Teknologjike (Kompjuter dhe Llaptop)	Mars 2022	30,000.00€
Furnizimi me dokumentacion mjekësor	Në procedura të prokurimit	45,000.00€
Furnizim me material higjenik	Janar dhjetor 2022	20,000.00€
Furnizim me pelet	Kontrata e nënshkruar shkurt 2022	60,000.00€
Furnizim dhe servisim me aparate kundër zjarrit	Në procedura të prokurimit	5,000.00€
Renovimi i objekteve shëndetësore	Janar dhjetor 2022	50,000.00€
Furnizim me inventar për institucionet shëndetësore	Janar dhjetor 2022	100,000.00€
Pajisje mjekësore për nevoja të QKMF-së	Janar dhjetor 2022	250,981.00€
Ndërtimi i objektit të AMF Gllamnik (bashkëfinancim me donator Chatar Charity)	Janar Dhjetor 2022	175,000.00€ Donatori 50,000.00€ Komuna

II.2. *Sektori i Mirëqenies Sociale*

<ul style="list-style-type: none">• <u>Vlerësimi i aplikacioneve të familjeve për Subvencione Shëndetësore dhe marrja e vendimit për të i'u ofruar ndihmë.</u>
<ul style="list-style-type: none">• <u>Përkrahja e OJQ-ve të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Podujevës dhe të cilat si aktivitet kryesor kanë ofrimin e shërbimeve socio- ekonomike.</u>
<ul style="list-style-type: none">• Pranimin dhe regjistrimin e të gjitha kërkesave të familjeve në nevojë.
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëpunim me shoqata dhe donator të ndryshëm, njerëz të vullnetit të mirë, përpilimin e listave prioritare të familjeve në nevojë për të i'u ndihmuar me pako ushqimore - higjienike, veshmbathje, dru për ngrohje, hapjen e puseve me ujë të pijshëm, strehim etj.
<ul style="list-style-type: none">• Evidentimi dhe vizitat te familjet të moshuar, vetmuar dhe hendikepuar duke i'u ofruar ndihmë në kuadër të mundësive të DSHMS-së.
<ul style="list-style-type: none">• Do të vazhdohet procesi i hapjes së puseve me ujë të pijshëm për familjet e përzgjedhura në bashkëpunim me Organizatën “Qatar Charity”.
<ul style="list-style-type: none">• Vazhdimi i projektit për verifikimin dhe vlerësimin në përzgjedhjen e familjeve për strehim. Ndërtimi i shtëpive në bashkëpunim me Shoqatën Jetimat e Ballkanit për përzgjedhjen e familjeve përfituese.
<ul style="list-style-type: none">• Projekti për ndërtimin e shtëpive në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptarët për Shqiptarët.
<ul style="list-style-type: none">• Bashkëpunim me donatorë të ndryshëm për riparimin e shtëpive dhe përmirësimin e kushteve të banimit të familjeve në nevojë.
<ul style="list-style-type: none">• Regjistrimi në bazën e të dhënave i kërkesave dhe përfituesve.
<ul style="list-style-type: none">• Vizitat vlerësuese në Lagje të Dëshmorëve, ku me anë të këtyre vizitave konstatojmë zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve.
<ul style="list-style-type: none">• Vizitat e veçanta të cilat bëhen mbi bazën e një lëmie të caktuar. Ky lloj i vizitave zbatohet në raste të veçanta dhe kërkon përgjigje të shpejtë. Zakonisht zbatohet me kërkesë të veçantë të institucionit apo të palës.

III. Plani i punës i Qendrës për Punë Sociale

QPS është institucion publik profesional i nivelit Komunal, kompetent për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë sociale, brenda territorit administrativ të komunës. QPS kujdeset që banorët e sajë në nevojë për shërbime sociale t'i gëzojnë të drejtat e tyre për shërbime, pa dallime race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni dhe orientime tjera, me qëllim që çdo person apo familje në nevojë, e cila është banore e komunës, apo gjendet në territorin e Komunës së Podujevës të ketë qasje të barabartë në marrje të shërbimeve sociale, në kuadër të kompetencës ligjore në përkujdesje sociale.

QPS kryen dhe ofron shërbime të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale për personat dhe familjet në nevojë, sipas parimit të përkujdesjes dhe mirëqenies sociale, të përcaktuara në dispozitat e statutit të QPS, të Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjit për Familjen i Kosovës dhe akteve tjera nënligjore.

Plani operativ dinamik i Shërbimeve Sociale i Qendrës për Punë Sociale për vitin 2022

Objektivi	Legjislacioni	Aktiviteti-Veprimet	Periudha Kohore	Buxheti
	Ligji për Familjen, Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligji Kundër Dhunës në Familje, Ligji për përkrahjen e Fëmijëve me Aftësi të kufizuara, Udhëzimi Administrativ për Strehim Familjar, Udhëzimi Administrativ për identifikimin e Viktimave të trafikimit etj.	1. Respektimi i ligjeve dhe udhëzimeve administrative 2. Kontrollimi i vendimeve në harmoni me ligjin	I përhershëm	QPS, Komuna, DPSF
	Implementimi i doracakëve: 1. Doracaku mbi mbrojtjen e fëmijëve, 2. Komunikimi me fëmijë 3. Standardet minimale për Kujdestari, Adoptim, fëmijët e braktisur, fëmijët e keqtrajtuar, fëmijët me sjellje asocial, delikuenca, fëmijët me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe besimi I fëmijëve me kontaktim	Shikimi i lëndëve dhe vërtetimi mbi implementimin e doracakëve	I përsheshem	QPS, DPSF, MPMS
	Kodi i Etikës	Respektimi i parimeve themelore të kodit të etikës	I përsheshem	QPS, DPSF, MPMS

Mbrojtja e Fëmijëve 1.Fëmijët pa përkujdesje prindërore		Vuarja nën kujdestari, përcjellja e rasteve, vizitat dhe raportet, ndihma në asistencë sociale, strehimi tek farefisi	I përkohshëm	QPS, DPSF, MPMS, Shkollat, K. Komunal
Fëmijët e braktisur		Caktimi i kujdestarit, strehimi familjar, mundësia e kthimit në familjen biologjike	Janar-dhjetor	QPS, DPSF, OJQ, MPMS
Fëmijët me sjellje asociale		Evidentimi bashkëpunimi me familje, me shkollë , me OJQ	Mujore	QPS, DPSF, MPMS, Shkolla, K.Komunal OJQ
Të Moshuarit		Përkujdesja për të moshuarit pa përkujdesje familjare Strehimi	I përhershëm	
Fëmijët e keqtrajtuar dhe të rrezikuar		Evidentimi, vërtetimi mbi keqtrajtimin, puna me prindër, me shkolla, me spitalin, me policin	I përhershëm	QPS, MPMS, Shkolla, K.Komunal, OJQ, Policia
Fëmijët me nevoja të veçanta		Evidentimi, Vizita, Mundësia e shkollimit, bashkëpunimi me Handikosin	I përhershëm	QPS, DMS, MPMS, Shkolla, K.Komunal, OJQ,
Fëmijët e prindërve me mardhënje të çrregullta		Puna me prindër, rregullimi i raporteve familjare	I përhershëm	QPS, DMS, MPMS, OJQ
Fëmijët e prindërve të ndarë		Besueshmëria e fëmijëve dhe kontakti prindër fëmijë	I përhershëm	QPS, DPSF, OJQ, MPMS, Gjykata
Delikuenca		Raporti i gjykatës dhe përcjellja e rastit deri në moshën 18	Sipas vendimit të Gjykatës	QPS, DPSF, OJQ, MPMS, Gjykata, Policia

Konfliktet bashkëshortore		Sanimi i marrëdhënieve bashkëshortore, Kontaktet, Bisedat me Bashkëshortët	3 mujor	QPS, DPSE, OJQ, MPMS
Dhuna Familjare		Evidentimi, strehimi i viktimës, ofrimi i ndihmës juridike, përcjellja e rastit, respektimi i Ligjit mbi dhunën në familje	6 mujor	QPS, Policia, Departamenti i drejtësisë, OJQ, Gjykata
Trafikimi		Evidentimi, strehimi, kontrole mjekësore, risocializimi, respektimi i rregullores antidrogë	12 mujor	QPS, OJQ, Policia, Gjykata, K.Komunal, MPMS, Departamenti i drejtësisë
Mbrojtja e personave të moshuarve pa përkujdes familjar		Strehimi në institucione, vizita, vizita në familje, asistencë sociale	I përhershëm	QPS, DPSE, MPMS, K.Komunal
Personat e rritur me nevojë të veçanta		Asistencë Sociale	I përhershëm	QPS, MPSE, Spitali, K.Komunal, MPMS
Trajnimet		Përfshirja e të gjithë nëpunësve të shërbimeve sociale në trajnim	I përhershëm	QPS, DMS, MPMS, K.Komunal, OJQ
Raportet		Raportet 3.6.9 dhe raporti vjetor	I përhershëm	QPS, DMS

Podujevë Shkurt 2022

Aprovuar nga:

Drejtori i DSHMS-së

Dr. Driton VELIU

